



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 194/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në shenja publike të trafikut, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 5450 (pesëmijë e katërqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 07.10.2013 nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se me 06 tetor 2013 në ora 21:30, në rreth rrotullimin e rrugës “Driton Islami” në Ferizaj personi Ilir Avdyli e ka vendosur posterin e subjektit politik PDK me numër 99 në shenja publike të trafikut.

Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë rast është vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme neni 33 pika b. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013, në ora 18:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën deklaroi se ankesa në fjalë është e pa bazë nga fakti se aktivisti të pa informuar e kanë bërë një veprim të tillë dhe menjëherë është hequr fotografia me simbolet e PDK,-së, për më tepër ka shtuar se, e gjithë kjo ka ndodhur për shkak të mos njohjes së rregullave zgjedhore dhe kanë theksuar se në të ardhmen nuk do të ndodhë një veprim i tillë. Prandaj kanë propozuar që PZAP-i ta hedhë poshtë një pretendim të tillë si të pa bazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si posteri i subjektit politik PDK me numër 99 është i vendosur në shenjën publike të trafikut në rreth rrotullim gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik PDK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik PDK, përveç thënieve se veprimet e tilla kanë ndodhur nga aktivist të pa informuar dhe se është intervenuar në largimin e fotografisë me simbolin e PDK-së, me shpresë se në të ardhmen nuk do të ndodhë një veprim i tillë, subjekti politik nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes së supozuar, siç kërkohet nga dispozita ligjore e nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik PDK edhe më parë ka përsëritur shkeljen e natyrës së njëjtë të shkeljes duke e thyer Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët në këto zgjedhje, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 194/2013 më datën 09.10.2013.



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*